

Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në Seancën e përgjithshme, me të cilën kryesonte kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Besa Ademi, të mbajtur më 20.09.2024, në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit të gjykatave (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 58/06, 35/08, 150/10, 83/18 dhe 198/18 dhe “Gazeta Zyrtare e RMV” nr.96/19), neni 63 paragrafi (1) dhe (2) dhe neni 65 paragrafi (1) nga Rregullorja e punës së Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (“Gazeta Zyrtare e RMV” nr.14/22), duke vendosur mbi Iniciativën për miratimin e qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor, të paraqitur nga Ivo Mlladenovski, avokat nga Shkupi, nxori këtë:

K O N K L U Z I O N

Iniciativa e paraqitur nga Ivo Mlladenovski, avokat nga Shkupi, evidentuar nën Su-03 nr.543/24 të datës 23.08.2024, **NUK MIRATOHET.**

A r s y e t i m

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) pika 1 të Ligjit të gjykatave, avokati Ivo Mlladenovski nga Shkupi, paraqiti kërkesë në Gjykatën Supreme të RMV, të evidentuar nën 03Su.nr.543/24 të datës 23.08.2024, që Seanca e përgjithshme të miratojë qëndrim parimor dhe mendim juridik parimor, lidhur me veprimin e gjyqtarëve dhe nëpunësve në Gjykatën Administrative gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të aktgjykimeve të përgatitura, për mënyrën e veprimit me një aktgjykim konkret, si dhe mënyrën e sjelljes ndaj tij si palë në procedurën.

Paraqitësi në këtë iniciativë, kërkon që Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut të miratojë qëndrim parimor dhe mendim juridik parimor sipas të cilit në të ardhmen do ta detyrojë Gjykatën Administrative që gjatë dorëzimit të kopjes së vërtetuar nga aktgjykimet drejtuar palëve dhe të autorizuarve të tyre, të njëjtët detyrueshëm në pjesën ku përmenden të dhënat personale për procesmbajtës – këshilltar gjyqësor dhe për gjyqtarin kompetent, të theksohet qartë se të njëjtët janë nënshkruar në origjinalin e aktgjykimit përkatësisht në kopjen e vërtetuar të të dhënave të tyre personale detyrueshëm të theksohet d.v. respektivisht të nënshkruar me dorën e vet, në mënyrë që palët të mos dyshojnë aspak në autenticitetin e aktgjykimit ose se i njëjti vendim eventualisht është marrë nga persona të paautorizuar në kuadër të gjykatës. Njëkohësisht ta detyrojë Gjykatën Administrative që detyrimisht të gjitha aktgjykimet si dhe aktgjykimin konkret të përpunohen duke pasur kujdes afatin ligjor dhe të njëjtët të publikohen në ueb faqen e gjykatës sipas ligjit, në mënyrë që do të njoftohen me përmbajtjen e të njëjtëve edhe publiku më i gjerë.

Në bazë të nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit të gjykatave, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, miraton qëndrime parimore dhe mendime juridike parimore mbi çështje të rëndësishme për sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjeve nga gjykatat në afat prej 3 muajsh, por jo më gjatë se 6 muaj me vet iniciativë apo me iniciativë të kryetarit të gjykatës apo me iniciativë të seancave të gjyqtarëve apo sektorëve gjyqësor të gjykatave apo me iniciativë të avokatëve dhe i publikon në ueb faqen e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Dukshëm nga përmbajtja e Iniciativës edhe krahas asaj që është paraqitur sipas nenit 37 paragrafi (1) nënpika 1 të Ligjit të gjykatave, paraqitësi tregon vetëm për shkeljen e të drejtave të palës në procedurën gjyqësore të një lënde të caktuar me sjelljen e gjyqtarit, respektivisht personave zyrtar në gjykatë, por sipas dispozitës së theksuar ligjore nuk tregohet për ndonjë çështje të caktuar me kuptim të sigurimit unik në zbatimin e ligjeve nga gjykatat.

Duke marrë parasysh të sipër theksuarën, Seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut vlerëson se në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 37 paragrafi (1) të Ligjit të gjykatave, gjegjësisht nuk ka praktikë jo të barabartë gjyqësore në gjykatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në mënyrë që vendosi si në kumtimin e këtij Konkluzioni.

SEANCA E PËRGJITHSHME E GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT